



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 32/2021
Datë: 8 shkurt 2021

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj prokurores Fikrije Sylejmani, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në pajtim me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.11 dhe nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, sipas Raportit të Panelit Hetimor AD/KPK/05/2020/PTH - PR AD.nr.13/2020, të datës 21 dhjetor 2020, gjatë shqyrtimit të mbajtur më datë 08 shkurt 2021, në seancën e këshillimit dhe votimit morri këtë:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si i pa bazuar Raporti i Panelit Hetimor ZKPSH, AD/KPK/05/2020/PTH - PR AD.nr.13/2020, të datës 21 dhjetor 2020.
- II. **VËRTETOHET** se te Prokurorja Fikrije Sylejmani, nuk janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore, që bien ndesh me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, shkelje të detyrave të saj zyrtare si Prokurore, pika 1.3 dhe neni 6, paragrafi 2, pika 2.1 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë - Parimet e Përgjithshme, pika 3.4 dhe 3.5;

ARSYETIM

Më datë 07 tetor 2020, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga Autoriteti Kompetent, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor ndaj znj. Fikrije Sylejmani (ish Prokurore në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë), tani Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, duke propozuar që të hetohen veprimet e të njëjtës si dhe t'i shqiptohet masa disiplinore "Vërejtje jo publike me shkrim", në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Më datë 29 tetor 2020, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.25 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 12 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, nxjerr vendim me numër KPK/Nr. 530/2020, për Themelimin e Panelit Hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD/KPK/05/2020/PTH - PR AD.nr.13/2020, ndaj Prokurores Fikrije Sylejmani, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, për sigurimin e fakteve dhe mbledhjen e provave lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore.

Më datë 22 dhjetor 2020, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga Paneli Hetimor, ka pranuar Raportin AD/KPK/05/2020/PTH - PR AD.nr.13/2020, të cilit raport i janë bashkangjitur provat siç janë: deklarata e subjektit të hetimit disiplinor, znj. Fikrije Sylejmani, deklarata e [REDAKTUAR], ish Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, raportet vjetore për punën e subjektit të hetimit disiplinor për periudhën prej vitit 2013 deri në vitin 2017, të siguruara nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe subjekti i hetimit disiplinor. Paneli Hetimor, ka dëgjuar palën, subjektin e hetimit disiplinor, Prokuroren Fikrije Sylejmani.

Paneli Hetimor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së ankesës së Autoritetit Kompetent, pas vlerësimit të deklaratës së subjektit të hetimit disiplinor dhe analizimit të secilës provë veç e veç dhe në lidhmëri me njëra tjetrën, ka ardhur në përfundim se prokuroreja Fikrije Sylejmani, me sjelljen e saj, gjatë trajtimit të lëndës PP.II.370/2014 ka bërë veprime që nuk shkojnë në linjë me parimet e etikës dhe sjelljes profesionale për prokurore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në seancën disiplinore të mbajtur më datë 08 shkurt 2021, ka shqyrtuar raportin dhe ka dëgjuar raportimin nga Kryesuesi i Panelit Hetimor, i cili i ka elaboruar të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës disiplinore. Në seancën disiplinore, ka prezentuar edhe subjekti i hetimit disiplinor, prokuroreja Fikrije Sylejmani, në mbrojtjen e saj ka pohuar se ka ndodhë parashkrimi i rastit për të cilin ka filluar hetimi nga paneli hetimor. Është arsyetuar se kjo ka ndodhur për shkak të disa faktorëve objektiv siç janë: ngarkesa me lëndë, duke veçuar faktin se në vitin 2013 kur e njëjta ka filluar punën si prokurore, i ka pranuar 1100 lëndë, kushtet në të cilat ka funksionuar Prokuroria Themelore në Mitrovicë, duke potencuar faktin se në atë kohë aktivitetet e saj kjo Prokurori i ka kryer në objektin e Gjykatës Themelore në Vushtrri, ku për shkak të hapësirës se pa mjaftueshme në një zyre kanë punuar (5) pesë prokurore, pastaj vendimi i Kryeprokurorit që për një kohë të kryejnë lëndë në Stacionin Policorë në mungesë të kushteve të punës në objektin e Prokurorisë, ku si pjesë e këtij aktiviteti ka qenë edhe vetë subjekti i hetimit. Lidhur me rastin që është objekt i hetimit disiplinor, ka theksuar se në këtë rast ka ndër marrë veprime hetimore, duke e dëgjuar fillimisht të dëmtuarin, pastaj ka kërkuar raporte nga policia nga të cilët ka vërejtur se ai aktgjykim ka qenë i pa ekzekutueshëm dhe për këtë shkak e ka përgatitur rastin për pushim të hetimit. Tutje ka theksuar se asnjë nga palët nuk i ka njohur. Në fund është sqaruar se për shkak të ngarkesës së madhe me punë dhe kushteve të punës, ka mbetur pa përfunduar hetimi.

Bazuar në të gjeturat e Panelit Hetimor, sigurimin e të gjitha fakteve dhe mbledhjen e provave lidhur me rastin AD/KPK/05/2020/PTH - PR AD.nr.13/2020, Këshilli Prokurorial i Kosovës me shumicë të votave vendosi ta refuzoj si të pa bazuar raportin e Panelit Hetimor, pasi që me provat e prezantuara është vërtetuar se në veprimet e prokurores, e cila ka qenë subjekt i hetimit disiplinor, nuk janë gjetur elemente të shkeljes disiplinore që bien ndesh me Ligjin Nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë, me c' rast ka konstatuar se deri të lëshimet e prokurores të pretenduara nga ana e Panelit Hetimor ka ardhur si pasojë e kushteve të vështira të punës në të cilat prokurorja ka qenë e obliguar që t'i kryej detyrat e saj sipas autorizimeve ligjore.

Nga sa u tha më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të vlerësimit të çështjes morri vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial i Kosovës



T'u dërgohet:

- Z. Kujtim Munishi, Kryeprokurorë i Prokurorisë Themelore në Prishtinë;
- Znj. Fikrije Sylejmani, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
- Z. Haxhi Derguti, Kryesuesi i Panelit Hetimor;
- Arkivit të KPK-së;